



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR

Nr.Regj.Them. 63 (61005-00515-33-2025)

Data e Vendimit 09.08.2025

Datë regj. 08.08.2025

“SHKURTIM VENDIMI”
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër e përbërë prej:

GJYQTARE: F. Ç.

asistuar prej sekretares gjyqësore **B. Z.**, sot më datë 09.08.2025, përfundoi së shqyrtuari, në seancë gjyqësore publike çështjen penale Nr. 63 Regj. Them., që i përket

PROKURORIA PRANE GJYKATËS SË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR:

Përfaqësuar nga Prokurore **A. S.**

KUNDËR

F. T., i biri i D. dhe i Sh., i datëlindjes 02.xx.1964, lindur në Fushë Bulqizë dhe banues në lagja “Minatori”, Bashkia Bulqizë, me gjendje civile i martuar, arsimi 12 klasë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289-1 i Kodit Penal, përfaqësuar në gjykim nga av. D. M., zgjedhur me deklaram në seancë

B. Ç., i biri i Z. dhe i P., i datëlindjes 15.xx.1957, lindur dhe banues në Vajkal, Bashkia Bulqizë, me gjendje civile i martuar, arsimi 8 klasë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289-1 i Kodit Penal, përfaqësuar në gjykim nga av. D. M., zgjedhur me deklaram në seancë

E. K., i biri i A. dhe i A., i datëlindjes 03.xx.1989, lindur në Cëruh dhe banues në Klos, Bashkia Klos, me gjendje civile i martuar, arsimi 12 klasë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në

punë” të parashikuar nga neni 289-1 i Kodit Penal, përfaqësuar në gjykim nga av. D. M., zgjedhur me deklaram në seancë

E. Xh., i biri i H. dhe i Sh., i datëlindjes 29.xx.1974, lindur në Bulqizë dhe banues në Rr. “Kahraman Ylli”, Njësia Administrative nr.4, Bashkia Tiranë, me gjendje civile i martuar, arsimi 12 klasë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289-1 i Kodit Penal, përfaqësuar në gjykim nga av. D. M., zgjedhur me deklaram në seancë

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar si krim nga neni 289, parag. 1, i Kodit Penal.

Viktimë: F. V..

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, pasi administroi provat, shqyrtoi çështjen në tërësi si dhe dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve, ku prokurori kërkoi:

Prokurori kërkoi;

1. Të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë i personit nën hetim F. T., i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.
2. I dyshuari F. T. të lirohet dhe të procedohet në gjendje të lirë për hetimet e mëtejshme.
3. Të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë i personit nën hetim B. Ç., i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.
4. I dyshuari B. Ç. të lirohet dhe të procedohet në gjendje të lirë për hetimet e mëtejshme.
5. Të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë i personit nën hetim E. K., i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.
6. Të caktohet masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, për personin në hetim E. K..
7. Të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë i personit nën hetim E. Xh., i dyshuar për veprën penale të “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.
8. Të caktohet masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, për personin në hetim E. Xh..

Gjykata bazuar në nenet 228, 229, 230, 237, 244, 252, 257, 259 dhe 379 të K.Pr.Penale, si dhe në nenin 289. parag. 1, të Kodit Penal.

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të personit nën hetim **F. D. T.** i arrestuar nga policia gjyqësore si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar si krim nga neni 289, parag. 1, i Kodit Penal.

Urdhërohet lirimi i personit nën hetim **F. D. T.** nga ambjentet e Komisariatit të Policisë Dibër, nëse ndaj tij nuk ka ndonjë masë tjetër sigurimi ose vendim të formës së prerë.

3. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të personit nën hetim **B. Z. Ç.** i arrestuar nga policia gjyqësore si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar si krim nga neni 289, parag. 1, i Kodit Penal.

Urdhërohet lirimi i personit nën hetim **B. Z. Ç.** nga ambjentet e Komisariatit të Policisë Dibër, nëse ndaj tij nuk ka ndonjë masë tjetër sigurimi ose vendim të formës së prerë.

4. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të personit nën hetim **E. A. K.** i arrestuar nga policia gjyqësore si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar si krim nga neni 289, parag. 1, i Kodit Penal.

Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim E. A. K..

Urdhërohet personi nën hetim **E. A. K.** të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur me adresën:
Klos, bashkia Klos

Urdhërohet lirimi i personit nën hetim **E. A. K.**, nëse ndaj tij nuk ka ndonjë masë tjetër sigurimi ose vendim të formës së prerë.

5. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të personit nën hetim **E. H. Xh.**, i arrestuar nga policia gjyqësore si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar si krim nga neni 289, parag. 1, i Kodit Penal.

Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim E. H. Xh..

Urdhërohet personi nën hetim **E. H. Xh.** të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur me adresën:
Rr: xxxx, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Tiranë.

Urdhërohet lirimi i personit nën hetim **E. H. Xh.**, nëse ndaj tij nuk ka ndonjë masë tjetër sigurimi ose vendim të formës së prerë.

6. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për ekzekutimin e këtij vendimi.

7. Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer paraprakisht.

8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

9. U shpall në Peshkopi, sot më datë 09.08.2025

SEKRETARE

GJYQTARE

B. Z.

F. Ç.